




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	<i>DPK</i>
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	<i>02</i>
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	<i>03-02/232/12</i>
Data Datum Date	<i>04-09-2017</i>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.09.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-343/17 për z. Ilir Rexhepi – Anëtar i Bordit të Ndërmarrjes publike KRU “Prishtina”, për shkak se nuk ka prova që dëshmojnë për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur, me nr. protokoli AKK-03-02-343/17 ka qenë një pretendim nga pala e tretë me dyshimin për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, z. Ilir Rexhepi, Anëtar i Bordit, në ndërmarrjen publike KRU “Prishtina” dhe themelues i biznesit “Kosovo Mengament Institut”, ndërmarrje kjo e cila në ndërkohë, sipas deklarimeve të denoncuesit dhe verifikimit nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), ka fituar një projekt (02.11.2016) nga Autoriteti Rregullativ i Ujërave (ARRU) me temën “Hulumtimin i opinionit për shërbimet e ujit në të gjithë Kosovën”, e për çka dyshohet për konflikt interesi, sepse ish themeluesi i kësaj ndërmarrje tani është Anëtar Bordi i KRU “Prishtina”.

Për të hetuar këtë rast në detaje, fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z. Ilir Rexhepi (06/03.2017). Më pastaj, në takim, ai është njoftuar me situatën për të cilën dyshohet, janë vërtetuar disa nga argumentet e paraqitura, është pyetur për procesin e aplikimit për projektin në fjalë, dhe është elaboruar pozita e tij vendimmarrëse në Bordin e KRU “Prishtina”, pastaj edhe lidhja dhe raportet e varësisë mes KRU “Prishtina” dhe Autoritetit Rregullativ të Ujërave (ARRU).

Sipas të gjitha argumenteve të paraqitura dhe provave të mbledhura për rastin, Agjencia kundër Korrupsionit ka është konstatuar se të qenurit Anëtar i Bordit të KRU “Prishtina”, askujt nuk i jap kompetenca vendimmarrëse në Autoritetin Rregullator të ujërave (ARRU). Kjo për faktin se



ARRU është autoritet më i lartë sesa KRU “Prishtina”. Në fakt KRU “Prishtina” i nënshtrohet vendimeve të ARRU-së, si p.sh. në lidhje me licencimin, tarifat, standardet, performancën etj.

Për më tepër, për Projektin të cilin e ka fituar ndërmarrja në të cilën z.Illir Rexhepi dikur ishte themelues dhe Drejtor ekzekutiv, nuk ka vendosë as Autoriteti Rregullativ i Ujërave (në këtë rast si njësi kërkuese), e as KRU “Prishtina, por sipas Ligjit të Prokurimit Publik, ka vendosë Autoriteti Qendror i Prokurimit (AQP).

Kjo do të thotë se nuk ka asnjë lidhje që mund të quhet “konflikt interesi” sa i përket aspektit të vendimmarrjes që lidhet me funksionin e z.Illir Rexhepi si Anëtar i Bordit të KRU “Prishtina”, dhe të qenurit themelues i ndërmarrjes përfituese të projektit.

Këtu jo vetëm që nuk ka lidhje që do të cilësoheshin me “konflikt interesi” për sa i përket vendimmarrjes në lidhje me fituesin e projektit, nuk ka lidhje as sa i përket caktimit të kriterëve për projektin, sepse ato janë të bëra dhe të specifikuara nga Autoriteti Rregullativ i Ujërave (ARRU).

Me konkretisht, kriteret dhe specifikat i ka përcaktuar ARRU, ndërsa procesin e ka udhëhequr AQP.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit z.Illir Rexhepi e ka trajtuar për konflikt interesi (AKK-03-02-4653/16) pikërisht se ka pasur funksion të personit të autorizuar në biznesin “Kosovo Menagment Institut” duke qenë njëkohësisht edhe Zyrtar i lartë publik (Anëtar i Bordit në KRU “Prishtina”), dhe për këtë arsye z.Rexhepi ka heq dorë nga funksioni i tij menaxhues në biznesin e përmendur, për të ushtruar funksionin publik pa konflikt interesi. (Shih Vendimin e AKK-së, te dt.06.02.2017).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Shaip Havolli /

